

## KAMPI I EMERGJENCËS VORË

Kryeministri Rama, Komisioneri European për Menaxhimin e Krizave, Lenarčić, ministrja Balluku dhe ambasadorët Soreca e Cutillo, ishin në kampin e emergjencave Vorë, ku u takuan me banorët e akomoduar dhe inspektuan nga afër kushtet e jetesës. Kampi, ku janë vendosur qytetarët, banesat e të cilëve u dëmtuan nga tërmeti i 26 nëntorit, ofron ambiente të përshtatshme për strehim, por duke mundësuar edhe ushqim, shërbim mjekësor dhe kujdes pedagogjik për fëmijët.

## DËMET NGA TËRMETI NË MARIKAJ

Ministrja Belinda Balluku dhe Komisioneri European për Menaxhimin e Krizave, Janez Lenarčić, u ndalën në fshatin Marikaj, të bashkisë Vorë, ku panë nga afër disa prej banesave të dëmtuara nga tërmeti. Gjatë bisedës me banorët, këta të fundit u shprehën se aktualisht janë strehuar në çadrat e shpërndara nga ekipet e emergjencës në pritje të vlerësimit që ekspertët do të japin për banesat e tyre.

## KUJDESI PËR FËMIJËT PAS TËRMETIT

Një kujdes i veçantë iu është kushtuar fëmijëve, që ndodhen bashkë me prindërit të akomoduar në kampin e emergjencave në Vorë. Gjatë kësaj jave janë organizuar një sërë aktiviteteve argëtuese dhe pedagogjike. Janë shpërndarë libra dhe lodra për fëmijët e këtij kampi, ndërsa animatorë nga Teatri i Kukullave argëtojnë fëmijët duke bërë që të harrojnë për disa orë momentet e panikut nga lëkundjet e tërmetit.

## VLERËSIMI I DËMEVE TË TËRMETIT

Të gjitha agjencitë e varësisë së MIE, janë në terren me inxhinierët e tyre për të ndihmuar në procesin e konstatimit dhe vlerësimit të dëmeve nga tërmeti. MIE dhe Instituti i Ndërtimit janë duke udhëhequr këtë proces, ndërsa grupeve të punës u janë bashkuar edhe inxhinierë të ardhur nga vendet e tjera si Kosova, Greqia, Rumania, Zvicra, Izraeli, Italia, Franca etj.

## NDËRTIMI I BANESAVE TË DËMTUARA

Në fshatrat Dedej e Marqinet të Bashkisë Vorë, është drejt përfundimit ndërtimi i banesave, të cilat u dëmtuan si pasojë e lëkundjeve të tërmetit në muajin shtator. Aktualisht është duke u punuar në 24 banesa duke synuar përfundimin e tyre brenda këtij viti, ndërsa më pas do të vijojë puna edhe në banesat e tjera e dëmtuara.

## MASA PËR MIRËMBAJTJEN DIMËRORE

ARRSH ka nisur marrjen e masave, pas regjistrimit të reshjeve të para të dëborës në vend. Gjatë kësaj jave u ndërhyjë në disa prej akseve rrugore në veri të vendit, ku u bë pastrimi i aksit Qafë Mali-Fierzë, ndërsa në segmentet Mjedë-Pukë-Fushë Arrëz-Kukës është bërë trajtimi me kripë në vende të veçanta. ARRSH, dhe firmat kontraktore të mirëmbajtjes, janë në gatishmëri dhe në monitorim të vazhdueshëm të situatës.